Tema e sivjetme e festivalit është “Rruga e kujtesës”. Kështu, e kujtojmë të kaluarën e bukur të festivalit tonë, që i ka mbjellë farat e asaj që sot e mendojmë si fole ndërkombëtare të artit për artistë të rinj. Në polip 2024, eksplorojmë mënyrat e ndryshme se si puna kreative prodhon kujtesë. Nganjëherë, prodhimi i kujtesës bazohet në temën e zgjedhur nga shkrimtarët dhe artistët e tjerë. Nganjëherë ka të bëjë thjesht me kohën dhe hapësirën në të cilën krijohet një vepër arti. Edicioni i sivjetëm i festivalit do të përqendrohet në diskutimin e punës kreative si proces i ndërtimit të praktikave të kujtesës përmes përkujtimit të autorëve që nuk janë më në mesin tonë, angazhimit me punën e tyre, dhe diskutimeve për artin si proces transformues përmes të cilit çka ka qenë, çka është dhe çka duhet të jetë shkrihen në identitetin e të qenit artist.

Teksa reflektojmë për kujtesën në këtë edicion të rimenduar të polip-it, shohim se si artet janë përdorur për ndërtimin e narrativave të kujtesës. “Qëllimi i secilit artist është të kapë lëvizjen, që është jeta, me mjete artificiale dhe ta mbajë atë të palëvizshme, ashtu që pas njëqind vjetësh, kur një i huaj e shikon, ajo levis përsëri sepse është jetë,” ka thënë Uilliam Faulkner në një intervistë për The Paris Review diku kah mesi i të “50-ave. Duke e kapur lëvizjen, duke kapur narrativat historike në forma artistike, artistët ndërtojnë narrativa të kujtesës për brezat e ri. Për më tepër, arti ka formësuar kujtesën duke projektuar ëndrrat për të ardhmen, ide e vizione të reja.

Thënë shkurt, e kaluara dhe e ardhmja nuk janë subjekte të ndara. Ato e ushqejnë dhe i japin kuptim njëra tjetrës vazhdimisht. Ëndrrat për të ardhmen reflektojnë përvojat e së kaluarës dhe kujtesa për të kaluarën formësohet nga pritjet dhe vizioni për të ardhmen. Sidoqoftë, jo gjithçka që është e kaluar bëhet kujtesë. Proceset që e përcaktojnë atë që bëhet kujtesë kolektive janë shpesh diskriminuese, të njëanshme dhe ideologjikisht të ndikuara nga pushtetet e ndryshme. Ose kështu duket, të paktën. Për shkak se shpesh, më të zëshmit zaptojnë më shumë hapësirë ashtu që tregimet e tyre ose tregimet e atyre që ata duan të përceptohen sikur po i përfaqësojnë, dëgjohe më mirë. Sidoqoftë, kjo asnjëherë nuk i ka dekurajuar artistët nga lufta për atë hapësirë kolektive në të cilën shpesh e gjejnë veten duke i përfaqësuar zërat më pak të dëgjuar, përvojat e përditshme të njerëzve të thjeshtë, të stigmatizuara, të diskriminuara e të përjashtuarve.

Hapësira ku artistët krijojnë është më pak fizike e më shumë ideologjike e metafizike. Artistët krijojnë për të nesërmen.



PROGRAMMI

E PREMTE 17 MAJ

17:00 - 18:30 | SHESHI "ZAHIR PAJAZITI", PRISHTINË
KONSULTIMET POETIKE

ARTISTËT: ARBEN BAJRAKTARAJ, JULIE PEIGNÉ, LINDA RUKAJ, ALBULENA KRYEZIU BOKSHI, NADIA SARAGONI, AURITA AGUSHI, ANNE DUVERNEUIL, ADRIAN MORINA, AILTON MATAVELA, ARMEND SMAJLI, DAVIDE ARENA.

20:00 - 20:30 | TEATRI ODA, PRISHTINË
CEREMONIA E HAPJES, POLIP 2024

20:30 - 21:30 | TEATRI ODA, PRISHTINË
PERFORMANCA E KONSULTIMEVE POETIKE

INTRO: RICCARDO VENTRELLA (TEATRO DELLA PERGOLA - FIRENCE) DHE JULIE PEIGNE (THEATER DE LLA VILLE - PARIS)

ARTISTËT: ARBEN BAJRAKTARAJ, JULIE PEIGNÉ, LINDA RUKAJ, ALBULENA KRYEZIU BOKSHI, NADIA SARAGONI, AURITA AGUSHI, ANNE DUVERNEUIL, ADRIAN MORINA, AILTON MATAVELA, ARMEND SMAJLI, DAVIDE ARENA.

21:30 - 00:00 | TEATRI ODA, PRISHTINË
PERFORMANCA MUZIKORE:

LINDA RUKAJ & ARMEND XHAFERI

**E SHTUNË
18 MAJ**

12:00 - 13:30 | TEATRI ODA, PRISHTINË

**LEXIMI SKENIK DHE DISKUTIMI NË PANEL
PSE DRAMA?!**

ŽELJKO IVANOVIĆ, ELI KRASNIQI, SAŠA ILIĆ.

MODERATORE: ALIDA BREMER

LEXIME FRAGMENTESH NGA DRAMAT: ŽELJKO IVANOVIĆ, ELI KRASNIQI, SAŠA ILIĆ.

AKTORËT: KOSOVARE KRASNIQI, GENTRIT SHALA, YEJIR MEHA

REGJIA: GËZIM HASANI

*ME PËRKTHIM SHQIP-SERBIË-MALAZEZISHT

17:00 - 18:00 | TEATRI ODA, PRISHTINË

PROMOVIMI I LIBRIT:

SA CVEJOM U PRIŠTINI - ME CVEJËN NË PRISHTINË

MONOGRAFIA E BRANKO CVEJIĆIT

BRANKA PETRIĆ, SVETOZAR CVETKOVIĆ, BEKA VUČO

MODERATOR: JETON NEZIRAJ

*ME PËRKTHIM SHQIP-SERBIË

19:30 - 21:00 | TEATRI ODA, PRISHTINË

PERFORMANCA: UROTNICI (KOMPLOTISTËT)

PERFORMANCA: UROTNICI (KOMPLOTISTËT)

PRODUCENT: KROKODIL (BEOGRAD) NË BASHKËPUNIM ME

MY BALKANS (NEW YORK / BEOGRAD)

VLADIMIR ARSENIJEVIĆ & IGOR STIKS

REGJIA: BORIS LUJEŠEVIĆ

SVETOZAR CVETKOVIĆ, ISIDORA MINIĆ, DEJAN DEDIĆ, MARKO GRABEZ

21:30 - 22:30 | BUBBLE PUB, PRISHTINË

**POETIKA E TË PËRBASHKËTAVE:
LEXIME DHE MIKROFONI I HAPUR**

GREGORY PARDLO, LUNA AL-MOUSLI & ISRA DOGHMAN, SEJNUR VESHALL, MANJOLA NASI, IVANA BODROŽIĆ.

MODERATOR: AĜON REXHEPI

MIKROFONI I HAPUR PËR POETË QË DUAN TË LEXOJNË VEPRAT E TYRE

22:30 - 00:00 | BUBBLE PUB, PRISHTINË

PERFORMANCË MUZIKORE/DJ SET: LUNA AL-MOUSLI

**E DIEL
19 MAJ**

18:00 - 19:30 | TEATRI ODA, PRISHTINË

DISKUTIMI NË PANEL: KONTRATA KOLEKTIVE PËR DRAMATURGË

DORUNTINA BASHA, JONATHAN METH, JIBBE WILLEMS, JETON NEZIRAJ

MODERATORE: AULONË KADRIU

*NË ANGLISHT

20:00 - 22:30 | TEATRI ODA, PRISHTINË

PERFORMANCË MUZIKORE:

LLOCHI

PERFORMANCË LEXIMI

ME PJESËMARRËS TË PUNËTORISË SË SHKRIMIT KREATIV

ME GREGORY PARDONË

AGNESA MEHANOLLI, ÇLIRIMTARË JANUZAJ, LEONITA KUÇI, ELI KRASNICI, FISNIK EGËR,
LIRIDON HYSËNI, FLAMËR DARDËSHI, DANIELA GJOPALAJ, ANXHELA PIPERO, SARA BOCI,
GENTA ABDUJ, SËRANDA MEHMEDI, DHURATË ALIJA, GORAZD KITANOSKI

PROGRAMI KOMPLEMENTAR

17:00 - 18:30 | SHESHI PËRBALLË TEATRIT TË QYTETIT TË GJILANIT


KONSULTIMET POETIKE

ARBEN BAJRAKTARAJ, JULIE PEIGNÉ, LINDA RUKAJ, ALBULENA KRYEZIU BOKSHI, NADIA
SARAGONI, AURITA AGUSHI, ANNE DUVERNEUIL, ADRIAN MORINA, AILTON MATAVELA,
ARMEND SMAJLI, DAVIDE ARENA.

20:00 - 21:00 | TEATRI I QYTETIT GJILAN

PERFORMANCA E KONSULTIMEVE POETIKE

ARBEN BAJRAKTARAJ, JULIE PEIGNÉ, LINDA RUKAJ, ALBULENA KRYEZIU BOKSHI, NADIA
SARAGONI, AURITA AGUSHI, ANNE DUVERNEUIL, ADRIAN MORINA, AILTON MATAVELA,
ARMEND SMAJLI, DAVIDE ARENA.



DETAJET E PROGRAMIT

17 MAJ, PRISHTINË


17:00-18:30 | "Sheshi "Zahir Pajaziti", Prishtinë
20:00 - 21:00 | Teatri Oda, Prishtinë

KONSULTIMET POETIKE

18 MAJ, GJILAN

17:00-18:30 | Sheshi përballë Teatrit të Qytetit të Gjilanit
20:00 - 21:00 | Teatriti i Qytetit të Gjilanit

Artistë: Arben Bajraktaraj, Julie Peigné, Linda Rukaj, Albulena Kryeziu Bokshi, Nadia Saragoni, Aurita Agushi, Anne Duverneuil, Adrian Morina, Ailton Matavela, Armend Smajli, Davide Arena.




Konsultimet poetike janë mënyrë e re e të menduarit për marrëdhënien artist-audiençë. Të menduara fillimisht nga Emmanuel Demarcy-Mota, drejtor i Théâtre de la Ville në Paris, dhe autori Fabrice Melquiot, Konsultimet poetike janë biseda individuale me artistë. Biseda fillon me një dialog të lirë dhe përfundon me leximin e një poezie a kënge të zgjedhur, të përzgjedhur posaçërisht për personin para artistit. Kjo poezi a këngë jepet në fund të bisedës si 'recetë e personalizuar'. Konsultimet poetike përfaqësojnë poetikën e solidaritetit, së pari të paraqitur si praktikë përmes telefonit në kohët e vështira të pandemisë, dhe më pas fizikisht në parqe, kopshte, universitete e teatro në mbarë Evropën. Kësaj radhe ata janë në Kosovë - pjesë e edicionit të sivjetmë të POLIP-it.

Kjo formë e lidhjes mes artistit dhe audiencës ka bërë bashkë mbi 250 artistë nga 28 kombe në 18 vende të cilët tani funksionojnë si një komunitet, dhe ata sivjet u bashkohen artistëve të Kosovës. Konsultimet poetike në Kosovë organizohen në bashkëpunim me Théâtre de la Ville në Paris dhe Teatro della Pergola në Firenze.

18 MAJ, E SHTUNË, 12:00 - 13:30
Teatri ODA, Prishtinë

Panelist: Željko Ivanović, Eli Krasniqi, Saša Ilić.
Moderatore: Alida Bremer

PSE DRAMA?!



Shumë romancierë e poetë shpesh e orientojnë vëmendjen drejt teatrit dhe vendosin të shkruajnë drama. Zakonisht, ata e shkruajnë vetëm një dramë, sikur të kenë nevojë të eksplorojnë një territor të panjohur dhe më pas i kthehen shpejt habitatit të tyre tipik, ku ndihen më të sigurtë. Disa shkrimtarë të tjerë nuk ndalen vetëm me një dramë. Ata vazhdojnë të shkruajnë, siç është rasti i nobelistit Jan Fose. Në disa raste të rralla, edhe gazetarët provojnë të shkruajnë drama. Motivet për këtë 'migrim teatror' të gazetarëve janë të shumëllojshme. Ça duan ta testojnë veten e ca të tjerë ndihen sikur nuk ka asnjë medium përveç teatrit që u mundëson ta thonë atë që duan ta thonë. Sigurisht, lista e motiveve është shumë më e gjatë.

Si vendos shkrimtari a gazetari se një storie nuk mund të tregohet përmes prozës, esesë, reportazhit ose poezisë, por duhet të shkruhet si dramë? Ç'hapësirë ofron drama si gjini dhe teatri si medium – hapësirë që format e tjera të letërsisë ose gazetarisë nuk e ofrojnë? A është kjo "hapësirë" e shprehshme vetëm artistikisht apo ka të bëjë me "socialen" dhe "politiken"? Tre panelistët tanë janë profesionistë me përvojë në fusha të ndryshme. Eli Krasniqi, ndër tjerash, shkruan edhe poezi e prozë, por ka shkruar edhe një dramë. Saša Ilić është romancier, rrëfimtari e gazetar, por ka shkruar edhe një dramë. Željko Ivanović është gazetar, por ka shkruar edhe një dramë. Kjo është mundësi e mirë për të diskutuar për këto përvoja të reja me ta.

18 MAJ, E SHTUNË, 12:00 - 13:30
Teatri ODA, Prishtinë

Aktorët: Kosovare Krasniqi, Gentrit Shala, Yzeir Meha
Regjia: Gëzim Hasani


LEXIME FRAGMENTESH TË DRAMAVE NGA ŽELJKO IVANOVIĆ, ELI KRASNIQI DHE SAŠA ILIĆ



Mbreti i Çmendur nga Željko Ivanović

"Kur një mbret i çmendur arratiset pasi rrëzohet nga pushteti, logjikisht ajo arratisje duhet të jetë edhe çmenduri e llojit të vet. Ironikisht, personazhet e kësaj drame u përpoqën të gjenin paqe dhe shpëtim në azilin e të çmendurve nga çmenduria që mbretëron rreth tyre dhe që ka depërtuar në çdo pore të shoqërisë. Mprehtë dhe tragjikshëm, kjo dramë pasqyron një kryqëzim të gjendjes së shoqërisë që mbetet pas mbretit të çmendur. Për fat të keq, largimi i tij nuk është fundi i çmendurisë dhe pasojat do të ndjehen për një kohë të gjatë."

- Maja Todorović, dramaturge dhe skenariste



Citycide nga Eli Krasniqi

"Citycide" është dramë për kujtimet dhe dhimbjet e humbjes – së njëzëve dhe fragmenteve të qytetit. E vendosur në një restorant që shërben cianur, mysafirët, të vetëdijshëm për këtë "veçanti", presin me muaj për të rezervuar një vend. Restoranti përgatit aranzhimet e vdekjes dhe funeralit të mysafirëve të tij, duke theksuar përvojën argëtuese për udhëtimin e tyre të fundit. Në fokus të dramës është narrativa që shpaloset përmes një bisede mes dy mysafirëve, të cilët përfshihen në diskutime inteligjente dhe ndajnë rrëfimet dhe kujtimet e tyre prekëse. Drama, përmes këtyre rrëfimeve dhe shkëmbimeve, thekson nevojën e pamëshirshme që dhimbja të ketë dëshmitarë dhe të pranohet.

Teza e fundit për Fojerbahun Ditari i Dimitrije Tucovićit Saša Ilić

Ngjarjet e përshkuara në dramë paraqesin kohën e dobësimit të Internacionales së Dytë (1889-1916), daljen në pah të rrymave të ndryshme oportuniste brenda marksizmit original, të cilat kontribuan në shembjen e tij të plotë para rrezikut të luftës në tokën evropiane. Vetëm individë të rrallë mbetën në linjën e ideve origjinale socialdemokrate. Duke besuar deri në fund në idenë revolucionare të lëvizjes punëtore, Dimitrije Tucović u gjend pothuajse i vetëm në pragun e luftës më 1914, i mbështetur vetëm nga disa prej miqve dhe bashkëpunëtorëve të tij më besnikë. Kjo është një dramë për vitet e fundit të një luftëtari politik i cili, duke parë rënien e së majtës evropiane, u përpoq të sillte idenë e Internacionales së Dytë në Amerikë. Marksi shkroi Tezat e tij mbi Fojerbahun më 1845. Faqet e fundit të ditarit janë shkruar nga Tucović para vdekjes së tij më 20 nëntor, 1914. Temat e ngritura nga përfaqësuesit e së majtës serbe, jugosllave dhe evropiane në atë kohë kanë mbetur të nxehta edhe sot e kësaj dite: ndalimi dhe parandalimi i luftës, mbrojtja e të drejtave të punëtorëve, lufta për të drejtat e barabarta të grave dhe pakicave seksuale, liria e fjalës, kritika ndaj politikës koloniale, parandalimi i eksploatimit të punëtorëve dhe burimeve natyrore, ndalimi i garës botërore të armëve, lufta kundër racizmit, ngritja e standardeve të punëtorëve, forcimi i vetëdijes për të mirën publike dhe rëndësia e ruajtjes së mjedisit, dhe në fund lufta për ujë, ajër dhe tokë. Për secilën nga gjërat e listuara që e nevojshme të luftohej çdo ditë. Disa i kushtuan të gjitha ditët e jetës së tyre asaj lufte. Njëri prej tyre ishte Dimitrije Tucović. Por trashëgimia e tij politike, pavarësisht zhvendosjes së shpeshtë të eshtrave të tij gjatë njëqind viteve të fundit, nuk është marrë kurrë në konsideratë. Tucović kurrë nuk pushoi së shkruari, faktikisht deri në ditët e fundit në një llogore në Vrapçe brdo në nëntor 1914, kur u vra, duke e qëlluar tejprtej fletores së ditarit që mbante në xhepin e brendshëm të paltos së tij. Shkrimet e tij, të paktën pjesa e dukshme, e cila është në dispozicion sot, është dëshmi e llojit të vet për një njeri që donte ta ndryshonte botën. Ai s'e kishte idenë se këtë po e bënte me shkrimet e tij, të cilët do të udhëtojnë te ne për më shumë se njëqind vjet, si një porosi në shishe. Kjo dramë flet për këtë udhëtim.

18 MAJ, E SHTUNË, 17:00 - 18:00
Teatri ODA, Prishtinë

Panelistë: Branka Petrić, Svetozar Cvetković, Beka Vučo
Moderator: Jeton Neziraj

PËRURIMI I LIBRIT: SA CVEJOM U PRIŠTINI - ME CVEJËN NË PRISHTINË

Libri i titulluar "Sa Cvejom" ("Me Cvejën") përmban një varg tekstesh nga autorë të ndryshëm dhe është një dokument i rëndësishëm për një artist të jashtëzakonshëm dhe arritjet e tij në fushat e kulturës dhe artit, në qytetin, vendin dhe mbarë rajonin e ish-Jugosllavisë. Përgjatë librit, kujtime të ndryshme na çojnë nga koha kur Branko Cvejčić hyri për herë të parë në botën e artit, deri te disa shfaqje të paharrueshme në Teatrin Jugosllav të Dramës. Kujtimet shtrihen nga personazhi legjendar i Bane Bumbarit në serinë televizive "Grlom u jagode", deri në rolet e tij të fundit. Libri është i ndarë në tetë kapituj, ku secili kap momente të rëndësishme në jetën dhe karrierën e Branko Cvejčićit. Një konceptim i tillë na bëri të kërkojmë kontribues jo vetëm mes kolegësh dhe bashkëpunëtorësh të ngushtë të Cvejčićit në sferën kulturore, miq nga bota e teatrit dhe artit në mbarë rajonin e ish-Jugosllavisë, por edhe në sferën e tij private, para së gjithash te familja dhe miqtë e tij të ngushtë prej shumë vitesh. Asortimenti i pasur i teksteve të autorëve dhe fotografive të ndryshme të librit ofron edhe një pasqyrë të shkurtër të epokës në të cilën Cvejčić jetoi dhe punoi si artist, i cili gjithmonë mbeti i pranishëm dhe ia kushtoi jetën e tij artit me vetëmohim, gjithmonë duke pasur ndërmend kritere të larta etike, estetike dhe sociale. Cvejčić na la trashëgim disa arritje të mëdha që u materializuan pavarësisht vështirësive të mëdha të kohës së tij, dhe megjithatë nuk u njohën gjithmonë siç meritonin. Ky libër është një hap drejt njohjes së duhur të jetës së tij të pranishme dhe angazhimit vetëmohues në kulturën dhe artin tonë.

Branko Cvejčić nuk ishte vetëm dëshmitar a vëzhgues, por edhe pjesëmarrës aktiv në epokat e ndryshme të jetës së tij, qoftë në sferën e aktrimit, punën e tij si menaxher i përgjithshëm i një teatri të madh, qoftë identitetin civil dhe shoqëror, i cili, në rastin e tij, ishte i qartë dhe i qëndrueshëm. Kjo është arsyeja pse ky botim mbulon të gjitha ato dimensione të personalitetit të tij publik, dhe pashmangshmërisht mund të lexohet edhe si dëshmi e një kohe ose kohërash që u shënuan, në pjesën tonë të botës, me ngjarje të rrëmujshme e të trazuara. Një qasje e tillë është tejet e rëndësishme, sepse historinë ne e shohim jo vetëm si kthim në të kaluarën, por edhe si një lloj parashikimi i së ardhmes.

Libri, i cili filloi të marrë formë menjëherë pas vdekjes së Branko Cvejčićit, është edhe një përpjekje për të bërë rezistencë, të paktën në këtë hapësirë të vogël që është në dispozicion për ne, ndaj kulturës së përgjithshme të harresës që ka depërtuar në shoqërinë tonë. Një përshtypje e tillë e vërteton edhe një grup jo i papërfillshëm figurash të rëndësishme nga e kaluara jonë e fundit ose më e largët, në fusha të ndryshme të veprimtarisë profesionale, emrat e të cilëve janë lënë në harresë.



18 MAJ, E SHTUNË, 19:30 - 21:00
Teatri ODA, Prishtinë

Producent: Krokodil (Beograd) në bashkëpunim me
My Balkans (New York / Beograd)
Vladimir Arsenijević & Igor Stiks
Regjia: Boris Liješević
Svetozar Cvetković, Isidora Minić, Dejan Dedić, Marko Grabez

PERFORMANCA: UROTNICI (KOMPLLOTISTËT)



Çka ndodh kur, duke thyer të gjitha ligjet e hapësirës dhe kohës, takohen Bogdani, Borka, Mirko, Semi, Predragu, Svetlana, Saša, Miroslavi, Daša dhe Danilo? Dhe çfarë është lidhja e tyre me shkrimtarët, mbiemrat e të cilëve janë Bogdanović, Pavićević, Kovač, Mehmedinović, Matvejević, Slapšak, Hemon, Krleža, Drdnić dhe Kiš? Në ç'lloj komploti janë të përfshirë? Për çfarë lloj veprimi po na thërrasin?


Bazuar në tekstet e botuara në edicionin e Bibliotekës së Përbashkët (Zajednička čitaonica), u krijua kjo përzierje emocionuese zërash – një polifoni gjuhësore dhe artistike. Ajo dëshmon bindshëm se, edhe pse sot e gjejmë veten të ndarë në disa vende të ndryshme, nuk jemi të huaj për njëri-tjetrin, sepse në letërsi nuk ka pasaporta. Lidhjet që ekzistojnë mes të gjithë neve, të cilat mbështeten në trashëgiminë e përbashkët shoqërore si të gjuhës ashtu edhe të një trashëgimie të madhe letrare, janë shumë më të forta se forcat shkatërruese që në dekadat e fundit kanë prodhuar më shumë të këqija se që mund të kishim imagjinuar ndonjëherë. Kjo e keqe shtjellohet te Komplotistët, si një komplot për një të ardhme më të mirë. Letërsia ka vend kyç në këtë, sepse imagjinata sot për ne është më e rëndësishme se kurrë më parë. Lexuesit dhe shikuesit, të cilët flasin, përdorin, krijojnë dhe frymojnë në një gjuhë të përbashkët dhe së cilës i përkasin, kudo që janë, janë të ftuar në një aventurë leximi, zbulimi e mendimi. Kjo është shprehje e këmbëngulësisë së optimizmit dhe besimit të palëkundur se lidhjet mbi të cilat mbështetet republika letrare në Evropën Jugore, do të jetojnë tutje.

Përkundër dhe kundër.

18 MAJ, E SHTUNË, 21:30 - 22:30
Bubble Pub, Prishtinë

Gregory Pardlo, Luna Al-Mousli & Isra Doghman,
Sejnur Veshall, Manjola Nasi, Ivana Bodrožić.
Moderator: Agon Rexhepi

POETIKA E TË PËRBASHKËTAVE: LEXIME DHE MIKROFONI I HAPUR



Ndërsa bota po tkurret, me teknologjinë që na jep qasje më shumë se kurrë në sfidat tona të përditshme të rëndomta që në thelb duhet të na afrojnë me njëri-tjetrin, ne jemi edhe dëshmitarë të ngritjes së regjimeve të ekstremit të djathtë në tërë botën të cilët na ndajnë. Në Bubble Pub - pubi i parë queer në Prishtinë, do ta festojmë diversitetin dhe të përbashkëtat me autorë të ftuar nga Kosova, SHBA-ja, Kroacia e Shqipëria, ndërsa do të ketë një mikrofon të hapur për shkrimtarët në audiencë që dëshirojnë t'i lexojnë poezitë e tyre.

18 MAJ, E DIEL, 18:00 - 19:30
Teatri ODA, Prishtinë

Panelistë: Doruntina Basha, Jonathan Meth,
Jibbe Willems, Jeton Neziraj
Moderatore: Aulonë Kadriu

DISKUTIMI NË PANEL: KONTRATA KOLEKTIVE PËR DRAMATURGË




Meqë më shumë se mesatarja e popullsisë në moshë të punës është e vetëpunësuar, qasja në zhvillimin e shkathtësive nuk është e drejtpërdrejtë, veçanërisht duke marrë parasysh nivelet e të ardhurave të ulëta. Kjo kërkon bashkëpunim të ngushtë mes qeverive, institucioneve arsimore dhe partnerëve socialë në ofrimin e programeve arsimore dhe profesionale për sektorin.

Dramaturgët - si artistë të pavarur që punojnë brenda institucioneve teatrore - janë veçanërisht të prekur nga sfidat e ndikimit ekonomik të luftërave, COVID-it dhe një ekonomie evropiane që përipiqet të rritet. Ë dimë se punëtorët e teatrit po e braktisin profesionin e tyre meqë nuk kanë mundësi të rrinë.

Kontrata kolektive për dramaturgë do të shtjellojë mekanizmat kolektivë që avokojnë për "tregun" e dramaturgëve - a ka sindikata, shoqata e rrjete që i përfaqësojnë dramaturgët, cilat janë përfitimet dhe kufizimet e subjekteve të tilla dhe a ka bazë për praktika të tilla në nivel lokal në Kosovë? Në këtë diskutim me dramaturgë nga Kosova dhe Evropa, do të eksplorojmë edhe bazat për përfaqësimin kolektiv të dramaturgëve dhe se si institucionet publike të teatrit luajnë rol të rëndësishëm në përfaqësimin efektiv të një politike 'të ndershme' ndaj dramaturgëve. Tutje, do të diskutojmë për mekanizmat brenda BE-së që punojnë drejt këtij qëllimi. Do t'i shikojmë në veçanti modelet e dedikuara për dramaturgët që gjenden mes dy zjarreve, për të lidhur elementë të ndryshëm drejt një strategjie më të fortë lundrimi për dramaturgët e pavarur dhe për të krijuar kapacitet të zgjeruar për zhvillimin dhe përfaqësimin e tyre kolektiv.

PUNËTORIA E SHKRIMIT KREATIV ME GREGORY PARDLONË




Klisheja është mbase e vetmja gjë që poezia nuk mund ta tolerojë. Klishtë nuk janë veç fraza të stërpërdorura. Ato janë edhe figura, ide e rrëfime që shpesh i hedhim poshtë si "arsye e shëndoshë." Nëse arsyeja e shëndoshë u përket të gjithëve, atëherë nuk ka asgjë unike ose befasuese në të. Në këtë punëtori, do të flasim për strategjitë për gjetjen e lëndës së parë unike, emocionalisht të varrosur nën gjuhën e ndenjtur të klisheve. Do të gjejmë gjuhë që na befason dhe zbulon të vërteta të reja për mënyrën se si ne e shohim botën. Pjesëmarrësit duhet të presin të prodhojnë poezi të reja përmes ushtrimeve të shkrimit në klasë dhe diskutimeve në grup.

Gregory Pardlo

Gregory Pardlo është autor i koleksioneve poetike *Spectral Evidence and Digest*, fitues i Çmimit Pulitzer për Poezi. Librat e tij të tjerë përfshijnë *Totemin*, fitues i çmimit *American Poetry Review/Honickman Prize*, dhe *Air Traffic*, memoar në ese. Ndër çmimet e tij përfshihet bursa nga Qendra Cullman e Bibliotekës Publike të New Yorkut, Fondacioni i New Yorkut për Artet, Fondi Kombëtar për Artet dhe Fondacioni Guggenheim. Ai është bashkëdrejtor i Institutit për Studimin e Drejtësisë Racia Globale në Universitetin Rutgers-Camden dhe profesor mysafir i shkrimit kreativ në NYU Abu Dhabi.


PUNËTORI ME ALIDA BREMERIN: SA KREATIVE JANË PROFESIONET LETRARE?



Megjithëse letërsia është aktivitet kreativ dhe artistik, ka një anë artizanale të krijimtarisë që mund të mësohet. Kjo punëtori do të shtjellojë katër fusha të ndryshme tematike - që të gjitha sillen rreth krijimit të veprave letrare dhe strukturave të lidhura me to: shkrimi letrar, përkthimi i letërsisë, botueshmëria në Gjermani dhe përirimi i librit në panairt e librave në Gjermani. Punëtorja do t'i mbulojë këto tema: shkrimi kreativ, parimet e përkthimit, parimet e shpërndarjes së librit dhe udhëtimi nga ideja në librin e përfunduar.

Alida Bremer

Alida Bremer, e lindur më 1959 në Split/Kroaci, jeton në Münster/Gjermani. Ka mbaruar doktoraturën me tezën mbi romanin detektiv postmodern (Kriminalistische Dekonstruktion. On the Poetics of Postmodern Crime Novels, Königshausen und Neumann 1998). Në romanin *Olivas Garten* (Eichborn 2013, TB Ullstein 2017), ajo shkroi për familjen e saj dalmate që mori pjesë në rezistencën gjatë Luftës së Dytë Botërore; dorëshkrimi i saj i romanit *Träume und Kulissen* u propozua për Çmimin Alfred Döblin 2017 (Jung und Jung 2021). Poezitë, tregimet, esetë dhe romanet e saj janë përkthyer në disa gjuhë. Bashkë me Michael Krügerin, ka redaktuar antologjinë *Glückliche Wirkungen* (Ullstein 2017); bashkë me Ulla Hahnin dhe Andrea Grewen, Alida Bremer redakton kalendarin poetik *Fliegende Wörter* (Daedalus Verlag).



EKIPI QENDRËS MULTIMEDIA /
QENDRA MULTIMEDIA TEAM:

**FLAKA RRUSTEMI, ARDIANA SHALA, BUJAR BEKTESHI,
LULZIM REXHA, ADEM SALIHU, MURSEL BEKTESHI,
YANN PERREGAUX DIELF, ILIR GJOCAJ, BLERTA NEZIRAJ,
BERNARD BERISHA, AURELA KADRIU, JETON NEZIRAJ.**

ORGANIZED BY / ORGANIZUAR NGA:

**qendra
multimedia**

WWW.QENDRA.ORG // INFO@QENDRA.ORG // +383 (0) 38 555 799

   QENDRAMULTIMEDIA

SUPPORTED BY / MBËSHTETUR NGA:



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS
MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA

THE
SIGRID
RAUSING
TRUST



Rockefeller
Brothers Fund

Philanthropy for an Interdependent World



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD



Austrian
Embassy
Pristina



WBFB
Western
Balkans
Fund

Supporting Common Projects



Komuna e Prishtinës
Municipality of Pristina

PARTNERS / PARTNERË:



TEATRI
ODA

Théâtre
de la
Ville
PARIS

TEATRARIO
IDEELL'AL
IPER'IRIG'QIL'AL
TEATRO DELLA TOSCANA | FIRENZE



Teatri i
Qytetit
Gjilan

BUBBLE

MY BALKANS

krokodil
Engaging Words

ATA
Arts
Theater
Association



LOJA

ARTS AND
HUMANITIES
NYU ABU DHABI